



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **16.12.2024**, me fillim në orën **10:15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuari nënkryetar i komunës, **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **dymbëdhjetë (12)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2024;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025;
4. Shqyrtimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2025;
5. Shqyrtimi i planit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2025;
6. Shqyrtimi i njoftimit për shkëputje të kontratës së lokalit afarist;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, Hoçë e Madhe;
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, Hoçë e Madhe;
11. Të ndryshme.

### Shtesë:

12. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lirim nga taksa komunale Post-Telekomin e Kosovës.

**Përparim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për anëtarët e KPF-së! Telekom i Kosovës e ka bërë një propozim për një marrëveshje për investime të kabllor optike në tërë territorin e komunës së Rahovecit. Me rregullore për taksa dhe tarifa, Drejtoria e Shërbimeve Publike obligohet që të marrë taksë për telekom, apo për çfarëdo operatori tjetër ekonomik. Telekom i Kosovës është pjesë e qeverisë, pra, është aset kombëtar. Kërkojnë nga ne që së paku të lirohen nga taksa, kjo është ideja që, nëse pajtoheni, të marrim një vendim në kuvend që telekom të lirohet nga taksa e gërmimit.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për ekzekutivin, kolegët e KPF-së, të gjithë ju që jeni prezentë! Drejtor, ligjërisht a mund të bëhet vetëm me një vendim të asamblesë, apo duhet të bëhet plotësim-ndryshimi i rregullores mbi taksat dhe tarifat? Nëse bën vetëm me një vendim, në rregull jemi, sepse është në interes të komunës së Rahovecit.

**Përparim Krasniqi:** Ne kemi marrë vendim për lirim nga taksat për KEDS-in. Mendoj që duhet vetëm një vendim dhe t'ia japim dritën jeshile kompanisë Telekom.

**Kryesuesi:** Atëherë, këtë pikë shtesë e vendosim në votim, kush është "për"?... Me shumicë votash (7), vendoset edhe kjo pikë në rend dite. Atëherë, ky është rendi i ditës për sot, me një pikë shtesë. Nëse nuk ka dikush diçka, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Konstatoj që unanimisht (7 vota) votohet rendi i ditës për sot. Rendi i ditës i ka 12 pika.

### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë sugjerim apo vërejtje rreth procesverbalit? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Me 7 vota "për" aprovohet pika e parë.

### **2. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2024:**

**Nënkryetari:** Faleminderit, i nderuari kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive! Para vetes e keni një raport të punës së kryetarit të Komunës për vitin 2024. Ky raport është i shkurtër dhe secila drejtori do t'i publikojë në faqen ueb raportet më të gjera. Ky raport, realisht është dashur të diskutohet në 2025, mirëpo, kërkohet për performancë që të diskutohet brenda vitit kalendarik.

**Kryesuesi:** Faleminderit, nënkryetar! A kemi diçka në lidhje me raportin e punës së kryetarit? Nëse jo, atëherë vazhdojmë me pikën e tretë.

### **3. Shqyrtimi i planit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025:**

**Skender Hamza:** Përshëndetje kryesues, nënkryetar dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë! Ky projekt-plan është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet e tjera nënligjore. Ne si sekretari e kuvendit, në bashkëpunim me kryetarin e Komunës dhe kryesuesin e Kuvendit, e kemi përgatitur këtë projekt-plan për vitin 2025 dhe në bashkëpunim me OSBE-në, më datë 10 dhjetor 2024, kemi organizuar një punëtori me anëtarët e KPF-së dhe me ekzekutivin. Nga kjo punëtori kanë dalë disa propozime, vërejtje dhe sugjerime që janë përfshirë në këtë plan. Me këtë plan janë planifikuar të mbahen 12 mbledhje, 6 në pjesën e parë të vitit dhe 6 në pjesën e dytë. Sipas nevojës, mund të mbahen edhe mbledhje të tjera si seanca të jashtëzakonshme dhe ato që parashihen me ligj. Nëse keni ndonjë propozim, mund ta bartim për në Kuvend.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Skender! A kemi diçka në lidhje me planin e punës së Kuvendi? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht aprovohet pika e tretë.

### **4. Shqyrtimi i planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), për vitin 2025:**

**Skender Hamza:** Gjithashtu, edhe ky draft-plan i KKS-së mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. KKS-ja është këshill obligativ dhe kryesues e ka kryetarin e Komunës. Nga anëtarët e KKS-së kemi kërkuar propozime. Më datë 9 dhjetor është mbajtur mbledhja e fundit dhe ky plan është aprovuar nga anëtarët e KKS-së. Tani ka mbetur nga KPF-ja të cedohet për në Kuvend. Nëse keni ndonjë propozim, këtu jemi për t'i shënuar propozimet.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Skender! A kemi diçka në lidhje me planin e punës së KKS-së? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht aprovohet pika e katërt.

### **5. Shqyrtimi i planit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2025:**

**Senad Mullaavda:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje nënkryetar, ekzekutiv, anëtarë të KPF-së. Para vetes e keni projekt-planin e punës të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe që është formuar nga Kuvendi. Në këtë plan parashihen mbledhjet që do të mbahen gjatë vitit 2025. Nëse keni ndonjë propozim, jeni të mirëseardhur!

**Burim Krasniqi:** A ka vështirësi dhe sfida këshilli i Hoçës në punën e vet? A ka nevojë për diçka, ndonjë mungesë apo nevojë? Plan i punës nuk po e shoh që është ballafaquar me ndonjë sfidë, sepse ju jeni trupë mikse në mes të këshillit të fshatit, kishës dhe asamblesë komunale dhe është mirë që në fund t'i keni edhe nevojat tuaja, nëse keni vështirësi në realizimin e plotë të planit të punës, sipas ligjit mbi Hoçën e Madhe.

**Senad Mullaavda:** Faleminderit, z. Burim! Këtë sugjerim e marrim parasysht dhe e vendosim këtu. Përndryshe, sfidat i kemi të parapara në raportet 6-mujore. Bashkëpunimi është i mirë, puna e këshillit varet nga projektet dhe kërkesat e qytetarëve.

**Kryesuesi:** Faleminderit, Senad! A kemi diçka në lidhje me planin e punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht aprovohet pika e pestë.

#### **6. Shqyrtimi i njoftimit për shkëputje të kontratës së lokalit afarist:**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit, kryesues! I nderuari nënkryetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së! Kryetari i Komunës ju njofton me shkrim që do të shkëputet kontrata e lidhur në mes të Komunës dhe Skender Hamzës. Lokali afarist ndodhet në rrugën "Avdullah Bugari" pa numër, me sipërfaqe 30m<sup>2</sup>, me arsytimin e vetëm që pala nuk u është nënshtruar pagesave të rregullta, përkundër 8 vërejtjeve zyrtare me shkrim nga Drejtoria e Ekonomisë. Kur pala nuk i plotëson kushtet e parapara sipas kontratës, kryetari i Komunës e gëzon të drejtën e ndërprerjes së kontratës njëanshëm. Të gjitha këto obligime janë përcjellë në procedurë përmbarimore, për inkasim të dhunshëm të mjeteve.

**Defrim Kafexhiu:** Përshëndetje për të gjithë! Drejtorë të drejtorive, nënkryetar, anëtarë të KPF-së! Për mua si anëtar i Kuvendit dhe anëtar i KPF-së, e kam shumë vështirë t'ia kërkoj fjalën dikujt që është dënuar prej gjykatës themelore për manipulim votash. Kërkoj që Komuna e Rahovecit dhe Kuvendi i Komunës të reflektojnë në këtë pjesë, sepse është problem që ekzekutivi dhe ai që e kryeson legjislativin ta kenë nga një të dënuar prej institucioneve gjyqësore. Një drejtor që është i dënuar është përgjegjësi kryekëput e kryetarit, sepse ai e mbron dhe e shkarkon. Shumë më vështirë është kjo pjesë që gjendemi ne si kuvend komunal. Një pyetje për drejtorin: Kjo kontratë është lidhur prej vitit 2020. Në vitin 2022 janë bërë të gjitha vërejtjet që ju na keni bashkëngjitur në këtë material. Kjo qasje nuk është korrekte, në qoftë se komuna dhe Drejtoria e Ekonomisë u rri gati pronave dhe asetëve të komunës dhe nëse një qiramarrës nuk ka qenë në rregull në raport me pagesat, nuk besoj që Komuna duhet ta tolerojë 4 vjet, si dhe duke e marrë parasysht që vlera e qirasë për lokalin që po flasim është shumë e ulët në krahasim me zonën ku është ai lokal, pavarësisht se kush është personi që e ka lokalin.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, a ka obligime të tjera përveç kësaj pjese që është dhënë si vërejtje? Çka do të ndodhë me obligimet e qiramarrësit?

**Afrim Oruqi:** Në pyetjen e kuvendarit Defrim Kafexhiu: Drejtoria e Ekonomisë në vazhdimësi ka kërkuar që të përmbushet ky obligim, përmes vërejtjeve me shkrim dhe kontakteve me të. I njëjti, përveç një pagese të vetme, nuk u është nënshtruar pagesave të tjera. Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi: Lënda është në procedurë përmbarimore dhe obligimi është 1380€.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi edhe diçka tjetër në lidhje me pikën e gjashtë? Nëse jo, atëherë vazhdojmë me pikën e shtatë.

#### **7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK- Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës dhe Statutit të Komunës, kryetari i Komunës ju propozon që të merrni vendim për dhënien në shfrytëzim një parcelë të komunës, e cila gjendet në zonën kadastrale të Rahovecit, në sipërfaqe 2 ha e 50 ari. Kjo parcelë gjendet te Maja e Shkodranit, qëllimi ka të bëjë me zhvillim të turizmit dhe të rekreacionit. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim është 50 vjet. Çmimi fillestar do të caktohet në përputhje me rregulloret për taksa komunale në baza mujore.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, kjo kryesisht është gjatë rrugës te Maja e Shkodranit, prej pjesës së kompleksit. A do të ketë kufizime në çka do të lejohet të bëhet? Mos të keqkuptohem, sepse është e natyrshme që gurëthyes nuk lejohet, por për çka pretendohet të jetë, duke pasur parasysht që është për 50 vjet? A ka kërkesë orientuese, apo është vetëm vullnet i komunës, sepse e patëm një herë edhe një parcelë më lart dhe diçka nuk funksionoi dhe mbeti e padhënë në shfrytëzim. Një parcelë tjetër në atë zonë, a është e dhënë në shfrytëzim? Po flas gjithmonë për parcelën 02240-73, është e të njëjtit pozicion dhe nuk po e shoh që është bërë ndonjë investim. Nëse edhe kjo

parcelë është në shfrytëzim dhe nuk ka ndodhur investimi, atëherë mos ta bëjmë të njëjtin veprim edhe në këtë parcelë.

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për parcelën e cila saktësisht gjendet përballë pikës, te Maja e Shkodranit. Sipas PZhK-së do të jepet në shfrytëzim për turizëm. Do të përcaktohet prej komisionit se çfarë do të ndërtohet aty. Orientimi është që t'i përshtatemi zonës, të punohet me gurë, me dru dhe me gjelbërim. Muajve të fundit ka pasur interesim prej palëve të ndryshme, vendorë dhe të huaj që kanë shprehur interesim për investim në këtë parcelë.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi edhe diçka tjetër? Nëse jo, atëherë pikën e shtatë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (7) aprovohet pika e shtatë.

**8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 02240-76, ZK-Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, pikërisht për këtë parcelë, P- 02240-76. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 anëtarë nga ekzekutivi, 2 nga Kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi diçka tjetër rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë pikën e tetë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (7) aprovohet pika e tetë.

**9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, ZK - Rahovec:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për një parcelë me nr. 325-0. Parcela është e Komunës dhe ka sipërfaqe 1 ha, 28 ari e 37 m<sup>2</sup>. Parcela është në zonën kadastrale Hoçë e Madhe dhe është jashtë perimetrit të zonës së mbrojtur. Saktësisht është në anën e majtë të rrugës në drejtim të Suharekës dhe sipas PZhK-së është prodhim tretësor me shërbime tregtare, me shumicë dhe pakicë. Afati i propozuar i dhënies në shfrytëzim për këtë pronë komunale është 15 vjet.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, numri 00325-0 ZK Rahovec, sipas këtij propozim-vendimi, del të jetë një parcelë brenda Rahovecit në mes të disa shtëpive.

**Afrim Oruqi:** Është gabim teknik, në rend dite duhet të jetë ZK, Hoçë e Madhe.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi diçka tjetër rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë pikën e nëntë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (7) aprovohet pika e nëntë.

**10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër, të pronës së paluajtshme të komunës, P- 00325-0, Hoçë e Madhe:**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave, për këtë parcelë, P- 00325-0, Hoçë e Madhe. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 anëtarë nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi:** Faleminderit, drejtor! A kemi pyetje? Nëse jo, atëherë pikën e dhjetë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash (7) aprovohet pika e dhjetë.

**11. Të ndryshme:**

**Burim Krasniqi:** Në seancën e muajit gusht e kam bërë një pyetje, kur është diskutuar raporti i ZKA-së. Nuk kam pranuar kurrë përgjigje. Pyetja ishte rreth çështjes A4, ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec, ndërtimi i rrugës në hapësirën për biznes dhe turizëm, ndërtimi i rrugëve lokale (lot.1), ndërtimi i shtegut të ecjes – Rahovec, Drenoc, Polluzhë, Xërxë, Opterushë, ku potencohet që 20% të poenëve janë marrë te fituesi për shkak të planit dinamik. Unë e kam bërë pyetjen kështu: Këta përfitues a kanë qenë edhe më të lirë ekonomikisht, apo të satit kanë qenë në renditje sa i përket çështjes së çmimit të ofruar? Këtë pyetje e kam bërë, sepse është e qartë që Komuna e Rahovecit nuk ka pasur mjete financiare që projekti të zbatohet në afat kohor ashtu siç është thënë. E dyta, ceket qartë që në momentin e nënshkrimit të kontratës, automatikisht iu ka zgjatur afati, d.m.th nuk është kërkuar sipas planit dinamik. Nëse 20%-shi është përfutuar përmes planit dinamik dhe në kontratë plani është zgjatur dhe gjithashtu është më i shtrenjtë se operatori tjetër ekonomik, atëherë diçka nuk është në rregull këtu. Kërkoj gjithashtu një informatë prej Drejtorisë së Arsimit: Cila është arsyeja e çmimit për një ton pelet, 370€ (nëse nuk gaboj) që është nënshkruar kontrata për këtë vit dhe për një metër dru 80€. Në momentin kur ka qenë kontrata më e lirë dhe është ngritur çmimi i peletit për shkak të krizës së luftës në Ukrainë, operatori ekonomik e ka shkëputur kontratën dhe kemi pasur krizë në furnizimin e lëndëve djegëse në shkolla. Kur ka oferta në Gorenje

180-190€ një ton pelet dhe në këtë anë mbi 300€, për mua është e paarsyeshme. Ta kemi një informatë mbi bazën e asaj se si është bërë ky vlerësim dhe cila është arsyeja që të jetë ky çmim?


**Defrim Kafexhiu:** Mendova që e kemi edhe një pikë që e propozoi drejtori i Shërbimeve Publike. Nëse ka përfunduar diskutimi për atë pikë, atëherë unë e kam një propozim për një pikë shtesë për mbledhjen e rregullt të kuvendit. Diskutim mbi gjendjen e jashtëzakonshme për kryesuesin e kuvendit dhe drejtorin e Arsimit të Komunës së Rahovecit. E ftoj secilin anëtar të KPF-së, sidomos anëtarët e Aleancës që duhet ta bëjmë këtë diskutim, është një hap i vogël, sepse ne si Kuvend e kemi përzgjedhur me shumicë votash një kryesues që sot është i dënuar për veprën penale sipas aktakuzës në fjalë, gjithashtu që ka pasur aktakuzë të hapur në kohën kur e ka marrë pozicionin.

**Kryesuesi:** Dikush tjetër, atëherë propozimin e Defrimit e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, 3 vota “për”, 3 kundër dhe 1 abstenim dhe me votën time të dyfishtë, propozimi i Defrim Kafexhiut nuk kalon.

## **12. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lirim nga taksa komunale Post-Telekomin e Kosovës:**

**Kryesuesi:** Nëse dikush nuk ka diçka rreth kësaj pike?! E vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Unanimisht aprovohet edhe pika e fundit. Ju falënderoj për vëmendje, shihemi në mbledhjet e radhës!

Procesmbajtësi:

  
Albion Krasniqi

